



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR  
KRYESEKRETARIA

Nr.467 Akti

Tiranë, më 21.12.2023

**DËFTESË KOMUNIKIMI**

**Drejtuar:**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

**Z.BEHAR PIPERO DHE Z.ARDIT TABAKU**

Në zbatim të urdhërimit të gjykatës për komunikimin e vendimit Nr.467 datë 11.12.2023, bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin me nr.467, datë 11.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, qe i përket shtetasit Dhionisios Alfred Beleri, me objekt: "Kundershtimin e aktit nr.1938 prot, date 08.09.2023, njoftuar ne date 11.09.2023, pranimi i kërkesës per dhënie leje/autorizim te vecante" me qellim marrjen dijani nga ana Juaj.

Nënpunësi gjyqësor

Mora dijani më datë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE  
KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. Regj. Them. 467  
Dt. Regj. 16.11.2023

Nr. 467 Vendimi  
Dt. 11.12.2023

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët :

**ERJON ÇELA – Kryesues i seancës**  
**IRENA GJOKA – Anëtare**  
**FLORA HAJREDINAJ - Anëtare**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Erbolina Dardha**, sot më datë 11.12.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr. 467 Regj. Them. me palë :

**ANKUES :**

**Dhionisios Alfred Beleri**, i biri i Petro dhe i Kasiani, i datëlindjes 09.08.1972, lindur dhe banues në Himarë, me shtetësi shqiptare dhe greke, me gjëndje civile “*i martuar*”. Mbrojtur në gjykim nga **av. Edmond Demaj** dhe **av. Geni Gjyzari**, mbrojtës të zgjedhur me deklaram në seancë gjyqësore nga kërkuesi.

**OBJEKTI :**

Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë.

**KUNDËR :**

- 1.Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**, e përfaqësuar në gjykim nga prokurorët **Adnan Xholi** dhe **Dorina Bejko**.
- 2.Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, e përfaqësuar në gjykim nga **z. Behar Pipero**, i zgjedhur me autorizimin nr. 15432/1 prot. dt. 01.12.2023 dhe **z. Ardit Tabaku**, i zgjedhur me autorizimin nr. 12762/1 prot. dt. 09.10.2023.
- 3.Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës** (më

poshtë I EVP Durrës), i përfaqësuar në gjykim nga z.Ardit Londos, i zgjedhur me autorizimin nr. 4977 prot. dt. 01.12.2023.

**BAZA LIGJORE :** Neni 8, 73 i Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Gjykata, në seancën gjyqësore të datës 11.12.2023, dëgjoi diskutimet përfundimtare të palëve të cilët kërkuan :

- Ankuesi Dhionisios Alfred Beleri dhe mbrojtësi i tij – “... kërkojmë nga Gjykata, në zbatim të drejtpërdrejtë të Kushtetutës, duke qënë se nuk ka asnjë ligj që e pengon të drejtën e kërkuarit : Shfuqizimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lejimin e kërkuarit Dhionisios Alfred Beleri të kryejë procedurën e “Betimit” dhe shoqërimin e tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për këtë shkak në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Himarë që do të caktohet për këtë qëllim.”
- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – “... Nisur nga dispozitat ligjore që janë në fuqi konkludojmë se Neni 73 i ligjit 81/2020 ka parashikuar ndalimet dhe rastet specifike kur lejohet dhënia e një leje të tillë. Në rastin konkret nuk jemi para një rasti të tillë. Nëse kërkuari apo avokati kanë kontestime në lidhje me normat ligjore është vetëm Gjykata Kushtetuese që mund të shfuqizojë ato, nëse ka pretendime në lidhje me ligjin 81/2020. Në këto kushte kërkojmë rrëzimin e ankimit të kërkuarit si të pa pazuar në ligj dhe në prova”.
- Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve – “... Duke ju referuar fakteve të parashtruara sa më sipër, provave si dhe interpretimit të ligjit, çojmë se kërkesa penale është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar”.
- Përfaqësuesi i I EVP Durrës – “Nuk kemi për të shtuar, jemi dakord me qëndrimin e mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”,

si e shqyrtoi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. Rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes.

Ankuesi, Dhionisios Alfred Beleri në dt. 15.09.2023 ka paraqitur për gjykim para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ankimin penal me objekt : “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”, duke thirrur në gjykim në cilësinë e palëve të interesuara Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe I EVP Durrës. Kjo çështje i ka kaluar për shqyrtim

gjqtares Flojera Davidhi në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake<sup>1</sup> (gjykata ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së saj).

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (gjyqtari i seancës paraprake) pasi e shqyrtoi çështjen penale në dhomë këshillimi me vendimin nr. 371 dt. 18.09.2023 ka vendosur : “1.Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, për gjykimin e çështjes penale me nr. 371 regj. themeltar, datë regjistrimi 15.09.2023, që i përket, ankues: Dhionisios Alfred Beleri, me objekt : “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”. 2.Dërgimin e çështjes dhe akteve bashkëlidhur pranë gjykatës kompetente në pikëpamjen lëndore dhe tokësore për gjykimin e saj, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. 2.Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar në gjykatën kompetente. ...”.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (gjyqtari i seancës paraprake) ka arritur në këtë përfundim duke arsyetuar ndër të tjera sa mëposhtë : (cit. vendimi) “... 16. Sa sipër, duke qenë se kërkesa objekt gjykimi, nuk përfshihet në çështjet e rregulluara nga Kodi i Procedurës Penale, por nga ligji i posaçëm, ai me nr. 81/2020 dhe ky i fundit ka përcaktuar si gjykatë kompetente për çështjet që lidhen me të drejtat e të burgosurit, gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, atëherë Gjykata e Posaçme nuk është kompetente për gjykimin e çështjes objekt shqyrtimi. Gjithashtu, pavarësisht se vendimi që po ekzekutohet ndaj kërkuesit/ankuesit Dhionisios Alfred Beleri është një vendim i dhënë nga Gjykata e Posaçme (rivlerësuar masa e sigurimit) dhe urdhri i ekzekutimit është nxjerrë nga Prokuroria e Posaçme, dhe vetë ligji për ekzekutimin e vendimeve penale parashikon që për kontrollin e ekzekutimit njoftohet edhe prokurori që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, në asnjë rast çështja në lëndë të një prokurorie, nuk nënkupton automatikisht se bën kompetente edhe gjykatën pranë së cilës ajo prokurori ndodhet, por e kundërta po, një gjykatë kompetente bën për rrjedhojë edhe prokurorinë pranë saj kompetente. Kjo lidhet me parashikimin kushtetues se “Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj”<sup>2</sup>, dhe se “Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor”<sup>3</sup>. 17. Ligji i posaçëm, siç është ai me nr. 81/2020, vetëm në rastin e ankimit ndaj vendimit të ministrit të Drejtësisë për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm<sup>4</sup>, të të

<sup>1</sup> Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kërkesën penale regjistruar me nr. 83 regj.them., datë regjistrimi 31.07.2023, me objekt : “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 111, të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve Dhionisios Alfred Beleri dhe Pandeli Kokaveshi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal”. Çështja objekt gjykimi në seancë paraprake, i është nënshtruar shortit elektronik dhe në bazë të rezultatit të shortit i ka kaluar për gjykim gjyqtares Flojera Davidhi.

<sup>2</sup> Pika 1 e nenit 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>3</sup> Pika 3 e nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>4</sup> Duhet theksuar se në nenin 17 të Ligjit nr. 81/2020, parashikohet se: “1. Në raste të veçanta mund të zbatohet një regjim i

burgosurit, parashikon taksativisht si kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 18. Pasur në konsideratë se në vendimin e deklarimit të moskompetencës, Gjykata ka detyrimin të dërgojë edhe aktet pranë gjykatës kompetente në zbatim të nenit 85<sup>5</sup> të K.Pr.Penale, i referohemi nenit 80 të Ligjit nr. 81/2020 që bën kompetente gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Referuar vetë përmbajtjes së kërkesës ankimore, nga ankuesi parashtrohet se ai aktualisht është duke qëndruar pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penal Durrës, e për rrjedhojë çështja objekt gjykimi është kompetencë lëndore dhe tokësore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Pavarësisht se vendimi që ankimohet është ai i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe institucioni që ai drejton e ka selinë në Tiranë (me juridiksion në gjithë territorin shqiptar), vetë neni 80 i Ligjit nr. 81/2020 parashikon qartë se, ndaj vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale apo edhe të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ankimi bëhet në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal. 19. Thënë sa më lart, përfundimisht gjykata shpall moskompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për gjykimin e kërkesës penale nr.371 regj. themeltar, datë regjistrimi 15.09.2023, që i përket, ankues: Dhionisios Alfred Beleri, me objekt: “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë” dhe vendos dërgimin e akteve pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë penale. ...”.

Kjo çështje penale rezulton që të jetë regjistruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me Nr. 561 Regj. Them. Dt. Regj. 22.09.2023. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me vendimin nr. 137 dt. 10.10.2023 ka vendosur : “1. Të parashtrrojë para Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e kërkesës penale Nr. 561 regj. Them. dt. regjistrimi 22.09.2023, me objekt “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”. 2. dërgimin e kopjes së akteve Gjykatës së Lartë. 3. Një kopje e vendimit do ti dërgohet për njoftim Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka arritur në këtë përfundim duke arsyetuar ndër të tjera sa mëposhtë : (cit. vendimi) “... ky trup gjykues e vlerëson të gabuar interpretimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të bërë në kuadër të nenit 80 të ligjit nr. 81/2020. Gjykata e vendit të ekzekutimit në

---

posaçëm i ushtrimit të të drejtave për të dënuarit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen ose gjykohen për veprat penale të parashikuara në nenet 79, shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 265/a, 265/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste”. Pra, regjimi i posaçëm, i njohur ndryshe edhe “41 bis”, zbatohet edhe ndaj të paraburgosurve.

<sup>5</sup> Ky nen parashikon se: “1. Në qoftë se në gjykimin e shkallës së parë gjykata çmon se procedimi është në kompetencën e një gjykate tjetër, shpall me vendim moskompetencën e vet për çdo lloj shkaku dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente”.

kuptim të nenit 470 të K.Pr.Penale, është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Vendimet e formës së prerë janë vendimet e përcaktuara në nenin 462 të K.Pr.Penale. Masat e sigurimit personal janë veprime procedurale të cilat heqin ose kufizojnë liritë dhe të drejtat e personit të proceduar, të parashikuara nga ligji për të parandaluar atë në kryerjen e veprimeve, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, shmangjen nga procedimi dhe veprimtaritë e mëtejshme kriminale si dhe për të garantuar shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale. Zbatimi i masave të sigurimit personal rregullohet nga neni 246 i K.Pr.Penale dhe për çdo çështje që lidhet me zbatimin e tyre kompetenca i takon gjyqtarit të hetimit paraprak që i ka caktuar ato masa, në përputhje me nevojat e procedimit në funksion të të cilit ato janë. Në mënyrë alternative, nëse kjo gjykatë vlerëson se kjo çështje nuk i përket juridiksionit gjyqësor penal por ka natyrë administrative, në qëndrimin e këtij trupi gjykues, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk ka përcaktuar drejt kriteret ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e një parakushti të rëndësishëm procedural siç është ai i verifikimit të kompetencës lëndore. Në analizë të natyrës së çështjes, shkakut të saj ligjor, kërtimeve të palës ankuese, të parashtruara në kërkesën e depozituar dhe gjatë gjykimit të çështjes, si dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cënuar, Gjykata konkludon se kjo mosmarrëveshje ka natyrë materiale administrative. Në kuptim të përcaktimeve të mësipërme ligjore, Gjykata çmon se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi gjyqësor ka lindur nga një akt administrativ individual që është akti nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me të cilin është refuzuar kërkesa e të paraburgosurit Dhionisios Alfred Beleri, për dhënie leje të veçantë. Pikërisht, ky është akti që pala ankuese e kundërshton në gjykatë. ... Në kuptim të dispozitave të cituara, ky trup gjykues arrin në konkluzionin se zgjidhja e mosmarrëveshjes është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative, si një mosmarrëveshje që ka lindur nga akti administrativ individual, i nxjerrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik. ...”.

Me vendimin nr. 1810, dt. 07.11.2023 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë<sup>6</sup> ka përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente për të shqyrtuar çështjen penale me palë dhe objekt si më poshtë : Ankues – Dhionisios Alfred Beleri, Objekt “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”, Kundër – 1.Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, 2.Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, 3.IEVP Durrës.

Gjykata, çmon që të theksojë paraprakisht se përcaktimi i kompetencës lëndore të gjykatës për gjykimin e një mosmarrëveshje është një element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt

<sup>6</sup> Me vendimin nr. 1810, dt. 07.11.2023 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur : “Zgjidhjen e mosmarrëveshjes (konfliktit) së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. 2.Vendimi t'u komunikohet gjykatave në mosmarrëveshje”.

ligjor. Në lidhje me rëndësinë e përcaktimit të kompetencës lëndore Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 11 dt. 23.04.2009 ndër të tjera ka theksuar : “... shqyrtimi i një çështje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e të drejtës kushtetuese për tu gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykatë tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton. ... Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm ...”.

Në lidhje me kompetencën lëndore, Gjykata e Lartë në vendimin e sipërcituar ndër të tjera ka arsyetuar se : (cit. vendimi) “... 56. Përsa kohë që procedimi penal – gjykimi i çështjes – akuzës – ndaj të pandehurit të paraburgosur varet para gjykatës së gjykimit të çështjes në themel, e cila disponon rast pas rasti krahas gjykimit të procedimit kryesor, edhe lidhur me masën e sigurimit personal (të arrestit në burg) të caktuar ndaj tij në kuadrin e procedimit incidental të ‘implementuar’ gjatë fazës së hetimeve paraprake – në funksion të sigurimit dhe garantimit të procedimit kryesor – verifikimin e vazhdimësisë (edhe në këtë fazë të procedimit) dhe të qëndrueshmërisë së nevojave të sigurimit të këtij procedimi – edhe gjykimi i kërkesave për “lejë të posaçme” (gjatë kësaj faze) – vlerësimi – verifikimi -i kushteve të dhënies së tyre përsa kohë që implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe “integritetin” e këtyre nevojave (të sigurimit) – nuk mund të realizohet përtej dhe duke anashkaluar – filtrin e kontrollit juridiksional – konsensusin (vullnetin) substancial të organit (të procedimit penal) – të gjykatës (që procedon) të gjykimit të çështjes në themel. 57.Përfundimisht, mbi bazën e arsytimit të mësipërm, konsiderohet prej këtij kolegji, zgjidhja e konfliktit të kompetencës, midis gjykatës së juridiksionit të zakonshëm dhe asaj të juridiksionit special, ne favor të dërgimit për kompetencë gjykimi të çështjes pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. ...”.

Në këto kushte, çështja penale objekt gjykimi i ka kaluar përsëri për shqyrtim të njëjtit gjyqtar të seancës paraprake, gjyqtare Flojera Davidhi<sup>7</sup>. Ndërsa rezulton se kjo e fundit, ka depozituar brenda afatit ligjor 10-ditor në Kryesekretarinë e Gjykatës së Posaçme vendimin e arsyetuar nr. 83 regj. them., datë 14.09.2023 për dërgimin e çështjes në gjyq, në ngarkim ndër të tjerë edhe të ankuesit Dhionisios Alfred Beleri. Referuar shkresës kthim përgjigje të Kryesekretarisë së Gjykatës së Posaçme, çështja në themel në ngarkim të kërkuesit është regjistruar si çështja gjyqësore me nr. 104 akti, datë regjistrimi 20.09.2023 dhe po gjykohet nga trupa gjyqësore e përbërë nga gjyqtarët : z. Erjon Çela, znj. Irena Gjoka dhe znj. Flora Hajredinaj.

<sup>7</sup> Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (gjyqtari i seancës paraprake) pasi e shqyrtoi çështjen penale në dhomë këshillimi me vendimin nr. 371 dt. 18.09.2023 ka vendosur : “1.Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, për gjykimin e çështjes penale me nr. 371 regj. themeltar, datë regjistrimi 15.09.2023, që i përket, ankues: Dhionisios Alfred Beleri, me objekt : “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”. 2.Dërgimin e çështjes dhe akteve bashkëlidhur pranë gjykatës kompetente në pikëpamjen lëndore dhe tokësore për gjykimin e saj, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. ...”.

Sa mësipër, gjatë shqyrtimit të çështjes penale në dhomë këshillimi, Gjykata (gjyqtari i seancës paraprake) kryesisht ka vlerësuar edhe çështjen e pasjes apo jo të kompetencës funksionale për gjykimin e çështjes penale objekt shqyrtimi. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (gjyqtari i seancës paraprake) me vendimin dt. 17.11.2023 ka vendosur : “1.Deklarimin e moskompetencës funksionale për gjykimin e kërkesës penale me nr. 467 regj.them, datë regjistrimi 16.11.2023, që i përket: Kërkues- Dhionisios Alfred Beleri, me objekt: “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”. 2.Dërgimin e kërkesës penale dhe akteve bashkëngjitur për gjykim, trupës gjyqësore të themelit që po gjykon çështjen në ngarkim të të pandehurit Dhionisios Alfred Beleri, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të K.Penal, gjyqtarëve pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, z. Erjon Çela, znj. Flora Hajredinaj dhe znj. Irena Gjoka. 3.Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sëbashku me vendimin përfundimtar”.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (gjyqtari i seancës paraprake) ka arritur në këtë përfundim duke arsyetuar ndër të tjera sa mëposhtë : (cit. vendimi) “... Gjykata vlerëson se përsa kohë çështja në ngarkim të kërkuesit, Dhionisios Alfred Beleri, është tashmë për gjykim pranë trupës gjyqësore të themelit, pranë së cilës ndodhen aktet e çështjes, kompetencat e gjyqtarës së seancës paraprake kanë përfunduar dhe duke qenë se çështja objekt gjykimi kaloi pa short pranë gjyqtarës në fjalë, si gjyqtarja pranë së cilës ndodheshin aktet, tanimë kompetente për t’u shprehur lidhur me çdo kërkesë të kërkuesit, përfshirë edhe kërkesën objekt gjykimi do të jetë trupa gjyqësore e themelit. ...”.

Sa mësipër, çështja penale objekt gjykimi i ka kaluar për shqyrtim trupit gjykues i cili ka për gjykim në themel çështjen penale në ngarkim të të pandehurit/ankuesit në këtë gjykim Dhionisios Alfred Beleri, i përbërë nga gjyqtarët Erjon Çela (kryesues i seancës), Irena Gjoka (anëtare) dhe Flora Hajredinaj (anëtare)<sup>8</sup>.

Duke qënë kështu, Gjykata konstatoi se ka juridiksionin dhe kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje penale, kjo pasi Gjykata e Lartë me vendimin nr. 1810, dt. 07.11.2023 e ka përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente për të shqyrtuar çështjen penale. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata sjell në vëmendje edhe përcaktimin e nenit 86 pika 2 të K.Pr.Penale me titull “Vendimi i gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë mbi kompetencën” sipas së cilit : “Vendimi i Gjykatës së Lartë mbi kompetencën është i detyrueshëm, përveç rasteve kur dalin fakte të reja që çojnë në një përcaktim të ndryshëm juridik, nga i cili bëhet kompetente një gjykatë më e lartë”.

Kjo çështje do të shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, e njëjta trupë gjyqësore që aktualisht po gjykon çështjen penale në themel, pasi kjo është fryma që parashikon

<sup>8</sup> Shiko Urdhër Nr. 52 Dt. 25.09.2023 “Për dokumentimin e rezultateve të shortit dhe formimin e trupit gjykues” i Zv. Kryetarit të Gjykatës; Urdhër Nr. 58 Dt. 16.10.2023 “Për dokumentimin e rezultateve të shortit dhe formimin e trupit gjykues” i Zv. Kryetarit të Gjykatës.



edhe ligji procedural penal, unifikuar dhe nga Gjykata e Lartë, në rastin e masave të sigurimit personal si dhe lidhur me çdo kërkesë të paraqitur nga i pandehuri gjatë gjykimit të çështjes.

*Nga aktet procedurale dhe provat që i'u nënshtruan shqyrtimit gjyqësor rezultojnë këto rrethana fakti* : Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka pranuar aktet e procedimit penal nr. 489, datë 08.05.2023 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, duke i regjistruar në regjistrin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit e Krimin të Organizuar me numër procedimi penal nr. 111, datë 17.05.2023, për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurve Dhionisios Alfred Beleri dhe Pandeli Kokaveshi.

Nga aktet e procedimit penal nr. 489 të vitit 2023 rezulton se, nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, është referuar informacioni se dyshohej për aktivitet të kundërligjshëm të disa shtetasve në fushën e shitblerjes së votës për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023. Sipas informacioneve të marra nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë ka patur dyshime se personat e përfshirë në këtë aktivitet të kundërligjshëm i përkasin subjektit politik “Bashkë Fitojmë”. Nga të dhënat që disponoheshin dyshohej se këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin kundrejt përfitimeve materiale të marra nga kandidati për Kryetar Bashkie i Aleancës Politike “Bashkë Fitojmë”, i hetuari Dhionisios Alfred Beleri, marrin shuma me vlera monetare nga ky i fundit dhe i shpërndajnë ato kundrejt premtimit për votë nga shtetas të ndryshëm në Njësinë Administrative Hore-Vranisht dhe fshatrave që përmbledh kjo Njësi Administrative.

Rezultoni se pas regjistrimit të këtij procedimi penal, nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh procedurale hetimore në lidhje me hetimin e kësaj çështje penale dhe më konkretisht : janë marrë deklaratimet e personit që ka dijeni për veprën penale; është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit; është përpiluar autorizimi “Për lejimin e përdorimit të metodës speciale të hetimit për veprime simuluese dhe për lejimin e përgjimit dhe vëzhgimit”; është përpiluar autorizimi për vëzhgimin dhe përgjimin e fshehtë fotografik, filmik, audio dhe video, në vende publike; është vendosur lejimi i përgjimit të fshehtë fotografik, filmik, audio dhe video, në vende private, (vendim i cili është vlefshëm i ligjshëm nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr.42, datë 12.05.2023); etj.. Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore në dinamikë në lidhje me këtë procedim penal, nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe në bazë të rezultateve të përfuara nga këto veprime hetimore nga ana e organit të akuzës në dt. 12.05.2023 është kryer edhe arrestimi në flagrancë i shtetasit Dhionisios Alfred Beleri dhe i shtetasit Pandeli Kokaveshi si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal. Në kuadër të nevojave të këtij procedimi penal mbi bazën e kërkesës së organit të akuzës ndaj shtetasit Dhionisios Alfred Beleri nga ana e Gjykatës është caktuar dhe masa e sigurimit personal si mëposhtë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr.205, datë 13.05.2023 ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin ndaj shtetasit Dhionisios Alfred Beleri masën e sigurimit personal shtrengues atë të “Arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 46 datë 22.05.2023, ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.205, datë 13.05.2023 ndaj shtetasit Dhionisios Alfred Beleri si i dyshuar lidhur me veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” në bashkëpunim parashikuar nga neni 328 dhe 25 i Kodit Penal.

Kundër Vendimit nr. 46 datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka bërë ankim i pandehurit Dhionisios Alfred Beleri, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me Vendimin nr.19 datë 01.06.2023 ndër të tjera ka vendosur miratimin e vendimit nr.46 datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për masën e sigurimit “arrest në burg” caktuar për shtetasin Dhionisios Alfred Beleri.

Gjatë kohes që shtetasi Dhionisios Alfred Beleri ka qënë nën masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, në datën 14 maj 2023 në Republikën e Shqipërisë janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore ku ai ka qënë kandidat për Kryetar i Bashkisë Himarë i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Në bazë të rezultateve të votimit Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88 me vendimin nr. 194 dt. 16.05.2023 ka shpallur fitues z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri si Kryetar i Bashkisë Himarë, të propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Sa mësipër, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 611 dt. 25.05.2023 “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” ka vendosur : “1.Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”. 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. 3. (...)”<sup>9</sup>.

Mbi bazën e kërkesës së shtetasit z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me vendimin nr. 418 dt. 13.06.2023 në zbatim të nenit 60 të ligjit nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore” ka vendosur : “1.Pranimin e kërkesës. 2.Vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë z.Dhionisios (Alfred) Petro Beleri

<sup>9</sup> Shiko vendimin nr. 611 dt. 25.05.2023 “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. 3. (...)”<sup>10</sup>.

Gjatë kohës që çështja penale në ngarkim të të pandehurit Dhionisios Alfred Beleri ka qënë në fazën e hetimeve paraprake, nga ana e këtij të fundit rezulton që të jetë paraqitur edhe kërkesa me objekt "Zëvendësim i masës së sigurimit personal "arrest në burg". Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake) pasi e ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë me vendimin nr. 259 dt. 20.06.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi shtetasi Dhionisios Alfred Beleri ka ushtruar ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kjo e fundit me vendimin nr. 108 dt. 14.07.2023 ka vendosur : "I.Lënien në fuqi të vendimit me nr. 259 dt. 20.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. (...)”.

Pasi ka kryer hetimet çmuar të nevojshme në këtë rast, me vendimin e datës 19.07.2023, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka marrë si të pandehur shtetasin Dhionisios Alfred Beleri, duke i komunikuar akuzën për veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal. Po të njëjtën datë, Prokuroria e Posaçme i ka njoftuar të pandehurit dhe avokatëve mbrojtës përfundimin e hetimeve, si dhe i ka komunikuar të drejtat e parashikuara nga neni 327/4 i K.Pr.Penale.

Në datën 31.07.2023, Prokuroria e Posaçme ka përpiluar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, në kuadër të procedimit penal nr. 111 të vitit 2023 dhe e ka paraqitur atë pranë Gjykatës së Posaçme. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari i seancës paraprake) me vendimin nr. 83 dt. 18.09.2023 ka vendosur : "I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. II. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 111, të vitit 2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kundër të pandehurve: 1) Dhionisios Alfred Beleri, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të K.Penal. 2) Pandeli Kokaveshi, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të K.Penal, trupit gjykues të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. V. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. VI. Kundër këtij vendimi, për dërgimin e çështjes në gjyq, nuk lejohet ankim”.

Gjatë kohës që çështja penale në ngarkim të të pandehurit Dhionisios Alfred Beleri ka qënë për gjykim në seancë paraprake, nga ana e këtij të fundit rezulton që të jetë paraqitur përsëri kërkesë penale me objekt "Zëvendësim i masës së sigurimit personal "arrest në burg". Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari i seancës paraprake) pasi e mori në shqyrtim kërkesën me vendimin nr. 323 dt. 21.08.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa bazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim

<sup>10</sup> Shiko vendimin nr. 418 dt. 13.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i pandehuri Dhionisios Alfred Beleri dhe kjo e fundit me vendimin nr. 129 dt. 18.09.2023 ka vendosur : *“1.Lënie në fuqi të vendimit me nr. 323 dt. 21.08.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. (...)”*.

Ndodhur në këto kushte, i pandehuri Dhionisios Alfred Beleri (*ankuesi në këtë gjykim*) me qëllim kryerjen e betimit dhe marrjen zyrtarisht të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, i është drejtuar me shkresë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale 313 Tiranë, për një mbledhje të Këshillit Bashkiak të caktuar në datën 27.06.2023. Përgjigja për këtë kërkesë ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila e ka refuzuar kërkesën. Refuzimi i kërkesës i është njoftuar ankuesit, pasi kishte kaluar afati i mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, duke e bërë pa objekt ankimin e mundshëm në gjykatë kundër refuzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në të njëjtën kohë ankuesi, për shkak të kohës së shkurtër të njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë, i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin nr. 266, datë 26.06.2023 është shprehur se nuk ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kërkesës, pasi institucioni përgjegjës ishte drejtuesi i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku ndodhej kërkuesi.

Ankuesi i është drejtuar me kërkesë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Himarë të caktuar në datën 28.07.2023, kërkesë e cila është refuzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në lidhje me këtë refuzim ankuesi nuk mund t'i drejtohej gjykatës, duke qenë se refuzimi i është njoftuar pas zhvillimit të mbledhjes dhe kërkesa kishte mbetur pa objekt.

Ankuesi ka paraqitur kërkesë për dhënien e lejes/autorizimit të veçantë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve më datë 06.09.2023, me qëllim që pas shqyrtimit të kërkesës të kërkojë të caktohet një datë për zhvillimin e ceremonisë së betimit në Këshillin e Bashkisë Himarë. Me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka kthyer përgjigje në emër të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, ku ndodhet aktualisht kërkuesi, duke rrëzuar kërkesën e kërkuesit (*me argumentin se nuk jemi para asnjërit prej rasteve të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 81/2020*).

Sa mësipër, ankuesi, Dhionisios Alfred Beleri në dt. 15.09.2023 ka paraqitur për gjykim para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ankimin penal objekt gjykimi me anë të së cilit kërkon : *“Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”*, duke thirrur në gjykim në cilësinë e palëve të interesuara Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Durrës.

Në kërkesën penale objekt gjykimi si dhe në parashtrimet e bëra gjatë gjykimit ankuesi Dhionisios Alferd Beleri ndër të tjera pretendon se :

- Kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri aktualisht është i paraburgosur me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, miratuar me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
- Sipas vendimit nr. 611, datë 25.05.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, shtetasi Dhionisios Alfred Beleri është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Himarë në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Me vendimin nr. 418, datë 13.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është verifikuar mandati i kërkuarit, si Kryetar i Bashkisë Himarë.
- Me qëllim marrjen e detyrës së Kryetarit të Bashkisë, të fituar si më lart, ankuesi duhet të kryejë betimin e tij para Këshillit të Bashkisë Himarë.
- Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, kërkuesi gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg", ndaj tij dhe referuar vendimeve gjyqësore të cituara më lart nuk rezulton që ndaj kërkuarit të jetë marrë masë sigurimi ndaluese, apo t'i jetë ndaluar e drejta për t'u zgjedhur. Gjithashtu, nga organet e ngarkuara me ligj, KQZ, Gjykata si dhe Këshilli i Bashkisë Himarë, sipas neneit 60 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", pas verifikimit të kushteve të zgjedhjes dhe mandatit, ka rezultuar shpallja e vlefshmërisë së mandatit të tij si Kryetar i Bashkisë Himarë.
- Me qëllim kryerjen e betimit dhe marrjen zyrtarisht të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, ankuesi i është drejtuar me shkresë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale 313 Tiranë, për një mbledhje të Këshillit Bashkiak të caktuar në datën 27.06.2023. Përgjigja për këtë kërkesë ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila e ka refuzuar kërkesën. Refuzimi i kërkesës i është njoftuar ankuesit, pasi kishte kaluar afati i mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, duke e bërë pa objekt ankimin e mundshëm në gjykatë kundër refuzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në të njëjtën kohë ankuesi, për shkak se kohës së shkurtër të njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë, i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar, e cila me vendimin nr. 266, datë 26.06.2023 është shprehur se nuk ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kërkesës, pasi institucioni përgjegjës ishte drejtuesi i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku ndodhej kërkuesi.
- Ankuesi i është drejtuar me kërkesë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Himarë të caktuar në datën 28.07.2023, kërkesë e cila është refuzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në lidhje me këtë refuzim ankuesi nuk mund t'i drejtohej gjykatës, duke qenë se refuzimi i është njoftuar pas zhvillimit të mbledhjes dhe kërkesa kishte mbetur pa objekt.
- Ankuesi ka paraqitur kërkesë për dhënien e lejes/autorizimi të veçantë më datë 24.08.2023 Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kërkesë e cila ka mbetur pa përgjigje.
- Ankuesi ka paraqitur kërkesë për dhënien e lejes/autorizimit të veçantë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve më datë 06.09.2023, me qëllim që pas shqyrtimit të kërkesës të kërkojë të caktohet një datë për

zhvillimin e ceremonisë së betimit në Këshillin e Bashkisë Himarë. Ankuesi ka parashtruar se ligji për të drejtat e të paraburgosurve ka patur të njëjtat parashikime në lidhje me lejen e veçantë, pavarësisht ndryshimeve të ligjit në periudha të ndryshme kohore, megjithatë interpretimi që i është bërë rasteve për dhënien e lejes së veçantë ka qenë i ndryshëm për kërkues që kanë qenë mbështetës të pozitës, dhe i ndryshëm në rastin e tij. Kështu ankuesi ka parashtruar se të paktën në dy raste të njohura publikisht, praktika e ish-deputetit A.H dhe e ish-deputetit M.F, palët e thirrura në këtë gjykim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi të saj, kanë pranuar kërkesat e kërkuesve dhe kanë dhënë "Autorizim për leje të veçantë" për të marrë pjesë në seancë parlamentare. Konkretisht, ish-deputeti A.H është lejuar të betohet si deputet, pavarësisht se ka qenë me masën e sigurimit "arrest në burg".

- Me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka kthyer përgjigje në emër të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, ku ndodhet aktualisht kërkuesi, duke rrëzuar kërkesën e kërkuesit.
- Shkaqet e parashtruara në refuzimin për dhënien e lejes janë të pabazuara në ligj dhe në prova, pasi vendimi gjyqësor të cilit i referohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka refuzuar kërkesën e kërkuesit, por nuk e ka shqyrtuar atë, për shkak se kompetenca për shqyrtimin e saj i përket drejtuesit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku ndodhet kërkuesi, dhe gjykata shqyrtton ankimet kundër refuzimit, jo kërkesën. Bazuar në këtë vendim gjyqësor, ne i jemi drejtuar përsëri organit kompetent, dhe kundërshtojmë refuzimin e këtij institucioni si të pabazuar në ligj dhe në prova, pasi nuk ka asnjë vendim gjyqësor që të ketë shqyrtuar dhe rrëzuar kërkesën për dhënie autorizimi/leje të veçantë.
- Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" duke qenë se ankuesit nuk i janë kufizuar apo hequr të drejtat politike, kundërshtojmë refuzimin e kërkesës, aktin nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe kërkojmë pranimin e saj, si të bazuar në ligj dhe në prova.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore ndër të tjera parashtroi :

- Neni 8 i ligjit 81/2020 parashikon se : "Të burgosurit gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë kufizuar nëpërmjet vendimeve gjyqësore të dënimit ose të caktimit të masës së sigurisë "arrest me burg". Nga përmbajtja e ligjit 81/2020 ndër të drejtat që i garantohen të paraburgosurve të parashikuara në kreun II e në vijim të ligjit, ligjvënësi nuk ka parashikuar shprehimisht të drejtën e të paraburgosurit për të marrë pjesë në veprimtari/aktivitete jashtë ambjenteteve të IEVP-së dhe rrjedhimisht as ka ndonjë parashikim ligjor të posacëm për kërkesën e të paraburgosurit Beleri për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me qëllim betimin dhe marjen zyrtarisht të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë.
- E vetmja dispozitë ligjore që ligjvënësi ka parashikuar në këtë akt ligjor për normimin e lejeve të veçanta është neni 73 i tij, ku parashikohet se : 1.1 burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të

vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit. 2. Leja e veçantë për të dënuarin jepet nga drejtori i institucionit, ndërsa për të paraburgosurin jepet nga drejtori i institucionit, me pëlqimin paraprak të prokurorit. 3. Leja e veçantë jepet për një kohëzgjatje deri në 48 orë. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të burgosurit edhe 24 orë të tjera vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, të cilat vërtetohen me dokumentacionin përkatës. Zgjatja e lejes miratohet në përputhje me pikën 2 të këtij neni. 4. Kunder vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të refuzimit. Në dispozitën ligjore të mësipërme është parashikuar se institucioni që jep leje të veçantë në rastet e parashikuara në paragrafin e parë të saj, është Drejtori i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve. Ligjvënësi ka parashikuar se Prokurori jep vetëm pëlqimin paraprak në rastet kur investohet dhe i kërkohet mendim nga Drejtori i Institucionit. Në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite ligjore prokurorët e posaçëm mbajnë të njëtin qëndrim që kanë shprehur edhe në përgjigjen që i kanë kthyer shkresës me nr. 10945 prot. Dt. 28.08.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me këtë përmbajtje : "Prokurorët e posaçëm mund të japin pëlqimin paraprak për kërkesën e shtetasit Dhionisios Alfred beleri për dhënien e lejes së veçantë vetëm në rast se kërkesa e tij është në përmbushje të kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 73 të ligjit nr. 81/2020.

- Në lidhje me pretendimin e kërkuarit se ligji që parashikon të drejtat e të paraburgosurve apo të dënuarve me burgim është interpretuar ndryshe në rastin e shtetasve A.H dhe M.F, sjellim në vëmendje të gjykatës se kërkuari nuk ka bashkëngjitur ankimit të tij këto praktika por vetëm i përmend si raste. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë na kanë rezultuar vetëm dy vendimarrje për këta shtetas. Konkretisht vendimi datë 23.07.2001 i Kolegjit Penal për të pandehurin A.H me objekt "Ndryshimin e masës së sigurimit në bazë të nenit 260/2 të K.Pr.Penale", nëpërmjet të cilit gjykata ka vendosur revokimin e masës së sigurimit personal arrest në burg për shtetasin A.H. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton qartazi që situata e shtetasit A.H nuk është e njëjtë me rrethanat faktike dhe procedurale të shtetasit Dhionisios Alfred Beleri. Në rastin e të paraburgosurit A.H gjykata nuk ka patur për objekt shqyrtimi dhënien e ndonjë leje të veçantë për betimin e tij por ka shqyrtuar kërkesën e tij për zëvendësimin/revokimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me arsyetimin se në rastin e A.H nuk ekziston më rreziku i ikjes dhe se nuk ka të dhëna se mund të kryejë tjetër vepër penale si dhe për arsyen tjetër se mandati i tij si deputet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 73/2 të Kushtetutës në fuqi në vitin 2001 çdo veprimi mëtejshëm procedural ndaj deputetit të akuzuar mund të ndërmerret vetëm pasi nga organi i akuzës të jetë kërkuar dhe marrë autorizimi për ndjekjen penale nga Kuvendi. Ndërkohë që në rastin e z.Beleri gjykatat e të treja shkallëve të gjyqësorisë me vendimet përkatëse kanë arsyetuar se fakti që i pandehuri Beleri ka fituar mandatin e kryetarit të Bashkisë Himarë apo kërkesa e tij për tu betuar para Këshillit Bashkiak nuk është shkak ligjor që të çojë në zëvendësimin e masës së sigurimit arrest në burg me një tjetër masë sigurimi. Ndërsa në lidhje me shtetasin M.F na ka rezultuar vendimi nr. 17/5 datë 09.11.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lanë nëpërmjet të

cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së M.F për lejën e veçantë për të marrë pjesë si deputet i Kuvendit në komisionet përkatëse dhe në seancat plenare. Në këtë vendim gjyqësor gjykata ndër të tjera ka arsyetuar : "... Kolegji penal vlerëson se në rrethanat konkrete, masa e sigurimit personal e caktuar ndaj personit nën hetim M.F sipas ligjit e kufizon personin në një numër të caktuar të drejtash dhe lirish, përfshirë edhe të drejtën e tij për të ushtruar funksionin e deputetit me qëllim për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, kur janë të pranishme nevojat procedurale që kanë legjitimuar aplikimin e masës së sigurimit personal arrest në burg".

- Prokuroria e Posaçme vlerëson se, në rastin konkret kur gjykatat në mënyrë legjitime kanë vlerësuar, e më pas, kanë caktuar masën e sigurimit personal arrest në burg ndaj personit nën hetim, nevojat dhe interesat kushtetuese për zhvillimin e një procesi të regullt e të drejtë ligjor, duhet të konsiderohen si prevalue, në raport me tagrin e kryetarit të zgjedhur të Bashkisë ndaj të cilit zhvillohen hetime, për të marrë pjesën në aktivitetin e Bashkisë. Referuar kuadrit ligjor që normon vetqeverisjen vendore (ligji nr. 139/2015, neni 6) rezulton se ligjvënësi nuk ka parashikuar ndonjë afat prekluziv brenda të cilit kandidati i shpallur fitues duhet të bëjë betimin por vetëm ka parashikuar se : "Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës". Për këtë arsye kërkojmë bazuar në nenin 73 të ligjit 81/2020 : Rrëzimin e ankimit të paraqitur nga shtetasi Dhionios Alfred Beleri.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Durrës gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore ndër të tjera parashtruan :

- Në raport objektin e kërkesës penale, siç u evidentua edhe gjatë procesit të gjykimit : 1. Kërkesa me objekt "leje/autorizim i veçantë" është me karakter deklarativ dhe pa mbështetje ligjore. Në asnjë rast nuk ndodhemi përpara ndonjë vakumi ligjor siç pretendohet nga kërkuesi, por e drejta e pretenduar subjektive nuk është bazuar në ligjin material konkretisht ligji 81/2020 i cili disiplinon modalitetet dhe rastet se kur një i burgosur mund të përfitojë nga trajtimi me lejetë vecantë". 2. Në kërkesën e depozituar përpara gjykatës sikurse relatohet në përmbajtjen e saj por edhe në rrethanat për të cilat kërkohet "leja e veçantë", pala kërkuese nuk ka aritur që të identifikojë shkakun konkret dhe normën juridike në legjislacionin special, por edhe në normat nderkombëtare të së njëjtës fushë, për ti sjellë si analogji, vlen si shembull edhe rekomandimi (2006)2 i Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian "rregullorja evropiane e burgjeve. Rekomandimi Rec(2006)2 datë 11/01/2006 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, ka detyrues lidhur me zbatimin e tij nga shtetet anëtare, ku edhe kuadri ligjor regullativ i brendshëm duhet të jetë në përputhje me parimet dhe parashikimet ligjore në fjalë. Shteti Grek, rezulton që të ketë implementuar përcaktimet e këtij akti si shtet anëtar i Bashkimit Evropian.
- Edhe kuadri ligjor shqiptar specifik, ligji 81/2020 sëbashku me aktet ligjore në zbatim të tij ka inkorporuar parimet dhe specifikat ligjore mbi të drejtat dhe detyrimet e shtetasve të burgosur dhe trajtimin e tyre edhe në rubrikën e trajtimit të lejes/autorizimit të veçantë. Legjislacioni vëndas në të njëjtën frymë me rekomandimin Rec (2006)2 ka parashikuar se : "1.I burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën



e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.”. vetmja rrethanë shtesë që ka përcaktuar legjislacioni është “dhënia e provimeve të vetë të dënuarit” e cila është bërë në funksion të procesit rehabilitues në sistemin e burgjeve.

- Rrethana e kërkesës për betim për shkak të mandatit të Kryetarit të Bashkisë apo të deputetëve nuk është e parashikuar me ligj si rrethanë çka nënkupton që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e varësisë janë autoritete publike me kompetenca të llojit ekzekutiv dhe jo të interpretimit të rastit me analogji.
- Mungesën e shkakut ligjor kërkuesi e ka konsideruar si një kufizim i të drejtave të të burgosurit duke ju referuar nenit 8 të ligjit 81/2020. Kjo dispozitë ligjore nuk ka ndonjë rregullim të posaçëm apo referim të ndonjë aspekti apo procedure mbi lejën e veçantë të të burgosurve. Kufizimi i të drejtave të të burgosurve është një koncept ligjor i cili aplikohet nga sistemi i burgjeve për arsye që lidhen me aspektet e sigurisë, nevojat e emergjencës, fatkeqësitë natyrore, shkelje të akteve rregullative nga të burgosur të ndryshëm, rastet e vetëdëmtimit të tij apo dhe kur vendimet gjyqësore e urdhërojnë një gjë të tillë. Në rastin e kërkuesit nuk rezulton që të jetë nxjerrë ndonjë akt administrativ individual mbi kufizimin e ndonjë të drejte ligjore që lidhet me të në mënyrë të heshtur apo të shprehur. Objekti i kërkesës së A.Beleri për të marrë lejë të veçantë nga autoritetet penitenciare në rastin e betimit për mandatin e njësie të qeverisjes vendore apo dhe të funksionit të përfaqësuesit të parlamentit nuk është e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në të njëjtën linjë ka ecur edhe praktika e Gjykatës së Lartë me rastin e shtetasit Mark Frroku me vendimin nr. 17/5 dt. 09.11.2015 e cila ka konsideruar pajisjen me lejë të veçantë si deputet një trajtim të diferencuar i cili nuk parashikohet nga ligji për trajtimin e të burgosurve. Pra duke e konfirmuar praktikën administrative të ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- Duke ju referuar fakteve të parashtruara sa më sipër, provave si dhe interpretimit të ligjit, çmujmë se kërkesa penale është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

## **II. Ligji i zbatueshëm.**

Neni 8 i ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” me titull “Kufizimi individual i të drejtave të të burgosurit” parashikon se: “1. Të burgosurit gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë kufizuar nëpërmjet vendimeve gjyqësore të dënimit ose të caktimit të masës së sigurisë “arrest me burg”. 2. Të drejtat e të burgosurit, sipas këtij ligji, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj. 3. Kufizimi individual i të drejtave sipas këtij neni, nuk mund të cenohet të drejtën e të burgosurit për të komunikuar me mbrojtësin e tij dhe për të paraqitur ankesa në përputhje me parashikimet e këtij ligji”.

Neni 73 i ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” me titull “Lejë të veçanta” parashikon se : “1. I burgosuri ka të drejtë të përfitojë

leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit. 2. Leja e veçantë për të dënuarin jepet nga drejtori i institucionit, ndërsa për të paraburgosurin jepet nga drejtori i institucionit, me pëlqimin paraprak të prokurorit. 3. Leja e veçantë jepet për një kohëzgjatje deri në 48 orë. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të burgosurit edhe 24 orë të tjera vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, të cilat vërtetohen me dokumentacionin përkatës. Zgjatja e lejes miratohet në përputhje me pikën 2 të këtij neni. 4. Kundër vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të refuzimit. 5. Vendimi për dhënien e lejes së veçantë u njoftohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, të juridiksionit të vendit ku do të qëndrojë i burgosuri. 6. Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesës për leje të veçantë dhe dokumentacioni shoqërues përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve”.

### **III. Analiza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës.**

Në datën 16.11.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka regjistruar për gjykim çështjen penale me Nr. 467 Regj. Them. Kjo çështje penale ka ardhur për gjykim pranë kësaj gjykate pasi Gjykata e Lartë me vendimin nr. 1810, dt. 07.11.2023<sup>11</sup> ka përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente për të shqyrtuar çështjen penale me palë dhe objekt si më poshtë : Ankues – Dhionisios Alfred Beleri, Objekt “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë”, Kundër – 1.Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, 2.Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, 3.IEVP Durrës.

Ankuesi Dhionisios Alfred Beleri ka paraqitur ankimin me objekt “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë” duke parashtruar se : “... aktualisht është i paraburgosur me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, miratuar me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Sipas vendimit nr. 611, datë 25.05.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, shtetasi Dhionisios Alfred Beleri është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Himarë në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Me vendimin nr. 418, datë 13.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është verifikuar mandati i

<sup>11</sup> Me vendimin nr. 1810, dt. 07.11.2023 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur : “Zgjidhjen e mosmarrëveshjes (konfliktit) së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. 2.Vendimi t’u komunikohet gjykatave në mosmarrëveshje”.

kërkuesit, si Kryetar i Bashkisë Himarë. Me qëllim marrjen e detyrës së Kryetarit të Bashkisë, të fituar si më lart, ankuesi duhet të kryejë betimin e tij para Këshillit të Bashkisë Himarë. Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, kërkuesi gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg", ndaj tij dhe referuar vendimeve gjyqësore të cituara më lart nuk rezulton që ndaj kërkuesit të jetë marrë masë sigurimi ndaluese, apo t'i jetë ndaluar e drejta për t'u zgjedhur. Gjithashtu, nga organet e ngarkuara me ligj, KQZ, Gjykata si dhe Këshilli i Bashkisë Himarë, sipas neneit 60 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", pas verifikimit të kushteve të zgjedhjes dhe mandatit, ka rezultuar shpallja e vlefshmërisë së mandatit të tij si Kryetar i Bashkisë Himarë. Me qëllim kryerjen e betimit dhe marrjen zyrtarisht të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, ankuesi i është drejtuar me kërkesë për dhënien e lejes/autorizimit të veçantë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve më datë 06.09.2023, me qëllim që pas shqyrtimit të kërkesës të kërkojë të caktohet një datë për zhvillimin e ceremonisë së betimit në Këshillin e Bashkisë Himarë. Ankuesi ka parashtruar se ligji për të drejtat e të paraburgosurve ka patur të njëjtat parashikime në lidhje me lejen e veçantë, pavarësisht ndryshimeve të ligjit në periudha të ndryshme kohore, megjithatë interpretimi që i është bërë rasteve për dhënien e lejes së veçantë ka qenë i ndryshëm për kërkues që kanë qenë mbështetës të pozitës, dhe i ndryshëm në rastin e tij. Kështu ankuesi ka parashtruar se të paktën në dy raste të njohura publikisht, praktika e ish-deputetit A.H dhe e ish-deputetit M.F, palët e thirrura në këtë gjykim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi të saj, kanë pranuar kërkesat e kërkuesve dhe kanë dhënë "Autorizim për leje të veçantë" për të marrë pjesë në seancë parlamentare. Konkretisht, ish-deputeti A.H është lejuar të betohet si deputet, pavarësisht se ka qenë me masën e sigurimit "arrest në burg". Me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka kthyer përgjigje në emër të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, ku ndodhet aktualisht kërkuesi, duke rrëzuar kërkesën e kërkuesit. Shkaqet e parashtruara në refuzimin për dhënien e lejes janë të pabazuara në ligj dhe në prova, pasi vendimi gjyqësor të cilit i referohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka refuzuar kërkesën e kërkuesit, por nuk e ka shqyrtuar atë, për shkak se kompetenca për shqyrtimin e saj i përket drejtuesit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku ndodhet kërkuesi, dhe gjykata shqyrtan ankimet kundër refuzimit, jo kërkesën. Bazuar në këtë vendim gjyqësor, ne i jemi drejtuar përsëri organit kompetent, dhe kundërshtojmë refuzimin e këtij institucioni si të pabazuar në ligj dhe në prova, pasi nuk ka asnjë vendim gjyqësor që të ketë shqyrtuar dhe rrëzuar kërkesën për dhënie autorizimi/leje të veçantë. Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" duke qenë se ankuesit nuk i janë kufizuar apo hequr të drejtat politike, kundërshtojmë refuzimin e kërkesës, aktin nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe kërkojmë pranimin e saj, si të bazuar në ligj dhe në prova".

Nenin 73/4 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" përcakton se : "... 4. Kundër vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijani e

*vendimit të refuzimit. ...*". Sa më sipër, Gjykata fillimisht verifikoi faktin nëse ankimi është paraqitur brënda afatit ligjor. Në lidhje me këtë fakt, rezulton se vendimi për refuzimin e lejës së veçantë objekt ankimi është marrë nga Drjtoria e Përgjithshme e Burgjeve më datën 08.09.2023. Ky vendim rezulton që ti jetë dorëzuar mbrojtësit të ankuesit Dhionisios Alfred Beleri, av. Geni Gjyzari në dt. 11.09.2023<sup>12</sup>, kurse ankimi i ankuesit është depozituar në kryesekretarinë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 15.09.2023. Në këto kushte, Gjykata e konstaton ankimin e bërë kundër vendimit për refuzimin e lejës së veçantë të paraqitur brënda afatit ligjor të parashikuar nga ligji (neni 73/4 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve").

Duke mbajtur në konsideratë objektin e ankimit (*ankim kundër vendimit për refuzimin e lejës së veçantë/autorizimit me qëllim kryerjen e betimit*), Gjykata vlerëson se në thelb ankuesi/i pandehuri Dhionisios Alfred Beleri ndaj të cilit është caktuar dhe po zbatohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" si i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal kërkon lejë të veçantë me qëllim kryerjen e betimit dhe marrjen/ushttrimin zyrtarisht të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë të fituar në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Kjo pasi neni 60/4 i ligjit 139/2015 "Për qeverisjen vendore" përcakton se : "... 4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës. ...".

Nga interpretimi i dispozitës ligjore si më sipër si dhe dispozitave të tjera ligjore të parashikuara në kreun X të ligjit nr. 139/2015, arrihet në konkluzionin se betimi i personave të mandatuar në një detyrë publike siç është rasti i kryetarit të bashkisë, është lidhja kushtetuese dhe ligjore e personit të zgjedhur me funksionin që do të ushtrojë, të cilin duhet të betohet se do ta kryejë duke u udhëhequr nga interesat e shtetasve të bashkisë në të cilën është zgjedhur si dhe duke iu bindur Kushtetutës dhe ligjeve. Një procedurë e tillë është parashikuar edhe për Presidentin e Republikës, deputetët, për Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrat dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Ligji për vetëqeverisjen vendore e ka të shprehur në mënyrë eksplicite që betimi është parakusht për marrjen e mandatit dhe fillimin e ushtrimit të detyrës të kryetarit të bashkisë. Në këtë vështrim, legjislatori ka vendosur jo pa qëllim organin në të cilin duhet të kryhet betimi, i cili është i ndryshëm në varësi të pozicionit dhe funksionit të subjektit që kryen betimin. Në rastin konkret, kryetari i zgjedhur i bashkisë, ka detyrimin ligjor të kryejë betimin në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak, si organi kolegjial përfaqësues i shtetasve të bashkisë në të cilën është zgjedhur (neni 60/3 i ligjit nr. 139/2015 "Për qeverisjen vendore").

Në ndryshim nga rastet e sipërcituara nga Kushtetuta, ligji nr. 139/2015, i ka njohur

<sup>12</sup> Shiko shkresën nr. 613/1 prot. Dt. 07.12.2023 e Posta Shqiptare sh.a, Filiali Vlorë, me lëndë – kthim përgjigje sipas së cilës përcaktohet se : "... objekti postar me barkod EN237132977AA me dërgues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë dhe marrës av. Geni Gjyzari, Vlorë është dorëzuar më dt. 11.09.2023 kundrejt nënshkrimit të marrësit. Bashkëlidhur kopje e listës së dorëzimit të objektit të sipërpërmëndur".

mundësinë kryetarit të zgjedhur të bashkisë, të betohet edhe në një mënyrë tjetër, duke synuar që moskonstituimi apo pamundësia e mbledhjes së Këshillit Bashkiak brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga KQZ-ja, të mos bllokojë procedurën e betimit, e për rrjedhojë pamundësinë e ushtrimit të mandatit të kryetarit të bashkisë. Një mundësi e tillë parashikohet në mënyrë taksative në paragrafin 5 të nenit 60 të ligjit nr. 139/2015, i cili autorizon prefektrin që të organizojë ceremoninë e betimit të kryetarit të bashkisë *“në mjedisin e bashkisë dhe në prani të banorëve të njësisë përkatëse”*.

Përsa më sipër, betimi i Kryetarit të zgjedhur të bashkisë, si një parakusht për ushtrimin e funksionit të tij, mund të bëhet vetëm në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, ose nëse ky i fundit dështon të mbledhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga KQZ-ja, ceremonia e betimit mund të organizohet nga prefekti, në mjedisin e bashkisë. Duke qenë se ligjvënësi ka përcaktuar rastin e vetëm përjashtimor, procedura e betimit të kryetarit të bashkisë nuk mund të realizohet në asnjë formë tjetër, si dhe në asnjë mjedis jashtë atyre të parashikuara në ligj, pasi nuk do të krijonte asnjë efekt juridik.

Sipas pretendimeve të ankuesit, kërkesa duhet pranuar pasi bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, ai gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit *“arrest në burg”*. Nuk rezulton që ndaj kërkuarit të jetë marrë masë sigurimi ndaluese, apo t’i jetë ndaluar e drejta për t’u zgjedhur.

Palët e interesuara, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP Durrës thelbin e pretendimeve të tyre për rrëzimin e kërkesës e bazojnë në faktin se dispozitat ligjore që janë në fuqi (Neni 73 i ligjit 81/2020) kanë parashikuar ndalimet dhe rastet specifike se kur lejohet dhënia e një leje të tillë. Në rastin konkret sipas palës së interesuar nuk jemi para një rasti të tillë. Në rastin kur gjykatat në mënyrë legjitime kanë vlerësuar, e më pas, kanë caktuar masën e sigurimit personal *“arrest në burg”* ndaj personit nën hetim/të pandehurit, nevojat dhe interesat kushtetuese për zhvillimin e një procesi të regullt e të drejtë ligjor, duhet të konsiderohen si prevalue, në raport me tagrin e kryetarit të zgjedhur të Bashkisë ndaj të cilit zhvillohen hetime, për të marrë pjesë në aktivitetin e Bashkisë.

Ndodhur në këto kushte, kur ligji për qeverisjen vendore përcakton saktësisht procedurën dhe vëndin e kryerjes së *“betimit”*, gjykata konstaton se ndaj ankuesit Dhionisios Alfred Beleri i cili tashmë gëzon statusin e të pandehurit është vendosur kufizimi i lirisë personale me anen e caktimit të masës së sigurimit personal *“arrest në burg”*. Më konkretisht rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr.205, datë 13.05.2023 ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin ndaj shtetasit Dhionisios Alfred Beleri masën e sigurimit personal shtrengues atë të *“Arrestit në burg”*, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 46 datë 22.05.2023, ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit personal *“arrest në burg”* parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.205, datë 13.05.2023 ndaj shtetasit Dhionisios Alfred Beleri si i dyshuar lidhur me veprën penale

“Korrupsioni aktiv në zgjedhje” në bashkëpunim parashikuar nga neni 328 dhe 25 i Kodit Penal. Kundër Vendimit nr. 46 datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka bërë ankim i pandehurit Dhionisios Alfred Beleri, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me Vendimin nr.19 datë 01.06.2023 ndër të tjera ka vendosur miratimin e vendimit nr.46 datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për masën e sigurimit “*arrest në burg*” caktuar për shtetasin Dhionisios Alfred Beleri. Gjithashtu, ankuesi Dhionisios Alfred Beleri ka paraqitur për shqyrtim para gjykatës si gjatë fazës së hetimit paraprak ashtu edhe gjatë gjykimit në seancë paraprake kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit të cilat rezultojnë se nuk janë pranuar nga gjykata si të pa bazuara në ligj. Këto vendime gjyqësore rezultojnë që të jenë miratuar edhe nga gjykatat më të larta (*Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Lartë*)<sup>13</sup>.

Sa mësipër, duke qënë se kërkimet për zëvendësimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” janë marrë në shqyrtim nga gjykatat në një kohë të mëvonshme, edhe pasi ankuesi Dhionisios Alfred Beleri është shpallur fitues si Kryetar i Bashkisë Himarë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvilluara në datën 14.05.2023, përsëri gjykata duke i rrëzuar ato si të pa bazuara në ligj ka vlerësuar në thelb se aplikimi i masës së sigurimit “*arrest në burg*” do të thotë se nevojat për sigurim dhe mbarëvajtje të procesit gjyqësor në rastin konkret janë më të mëdha e më të domosdoshme se sa ato të vërtetuara nga llojet e tjera të masave të sigurimit personal.

Masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” konsiston, pikërisht, në urdhërimin për kapjen e personit dhe dërgimin e tij në një institut paraburgimi për të qëndruar në dispozicion të autoritetit procedues gjatë zhvillimit të hetimeve. Prandaj, për vetë faktin se kjo masë sigurimi konsiderohet si më ekstremja, kuptohet se edhe e drejta për të ushtruar profesionin, apo qoftë edhe mandatin e fituar nga zgjedhjet, duhet të konsiderohet si e papajtuashme me zbatimin e kësaj mase. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë arsyetimin sa mësipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret interesat kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt e të drejtë ligjor konsiderohen si prevalue në raport me tagrin e marrjes së mandatit për ushtrimin e detyrës së kryetarit të bashkisë nga ana e ankuesit Dhionisios Alfred Beleri ndaj të cilit aktualisht është duke u zhvilluar gjykimi në themel si i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal.

Në këto kushte, Gjykata arrin në përfundimin se duke qënë se, me vendim të gjykatës kompetente, ndaj ankuesit është vendosur kufizimi i lirisë personale me caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” ai nuk mund të ketë lirinë të paraqitet në asnjë nga vendet e cituara nga ligji për të mundësuar kryerjen e betimit. Kjo masë sigurimi, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, përbën një kufizim të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta, dhe mund të vendoset me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Në zbatim të dispozitës kushtetuese, ligji që përcakton dhe lejon kufizimin e të drejtave dhe lirive është Kodi i Procedurës Penale, i cili lejon organet gjyqësore që në bazë të kushteve dhe kriterëve ligjore, të vendosin

<sup>13</sup> Shiko faqet nr. 10 – 11 të pjesës “*rrethanat procedurale dhe faktike*” të këtij vendimi.

masën përkatëse përmes së cilës kufizojnë personin në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tij.

Masa e sigurimit personal "arrest në burg", e vendosur ndaj ankuesit, e cila megjithëse është një kufizim i të drejtave dhe lirive, personit të arrestuar në cilësinë e të pandehurit, në nenin 34/a dhe 34/b të Kodit të Procedurës Penale, parashikon një sërë të drejtash, të përcaktuara në mënyrë eksplicite. Në asnjë nga të drejtat e njohura nga ligji gjatë kohës që është në fuqi masa e arrestit në burg, nuk parashikohet mundësia që personi të lejohet për kryerjen e betimit apo marrjes së detyrës publike.

Gjithashtu, nga një analizë e legjislacionit të posaçëm lidhur me të drejtat e personave të cilëve i është kufizuar liria personale, në kushtet e paraburgimit, rezulton se ata mund të marrin leje të veçantë vetëm në kushtet e parashikuara në nenin 73 të ligji nr. 81\2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Kjo dispozitë ligjore përcakton se : "1. I burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit. Në asnjë nga këto parashikime nuk njihet e drejta e lejes së veçantë për kryerjen e betimit apo marrjes së detyrës publike. Gjykata vlerëson se këto raste kur ndaj të dënuarit me burgim apo të paraburgosurit mund të jepet leje të veçantë janë taksative dhe lista e tyre është e shteruese dhe parashikimi i nenit 73 i ligjit 81\2020 nuk lë hapësirë për Gjykatën që të mund të interpretojë se kjo listë e rasteve mund të jetë e hapur edhe për raste të tjera.

Gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore, ankuesi Dhionisios Alfred Beleri ngriti edhe pretendimin se praktika gjyqësore ka pasur raste kur ligji që parashikon të drejtat e të paraburgosurve apo të dënuarve me burgim është interpretuar në favor të dhënies së lejes së veçantë për të kryer betimin. Në lidhje me këtë pretendim ankuesi pavarësisht se nuk paraqiti vendimet gjyqësore i referoi ato me emrat e palëve në gjykim (rasti A.H dhe M.F). Vendimet gjyqësore si mësipër u depozituan në seancë gjyqësore nga organi i akuzës<sup>14</sup>. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve gjyqësore, Gjykata konstaton se vendimi datë 23.07.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për të pandehurin A.H është me objekt "Ndryshimin e masës së sigurimit në bazë të nenit 260/2 të K.Pr. Penale", nëpërmjet të cilit gjykata ka vendosur revokimin e masës së sigurimit personal arrest në burg për shtetasin A.H. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton qartazi që situata e shtetasit A.H nuk është e njëjtë me rrethanat faktike dhe procedurale të shtetasit Dhionisios Alfred Beleri. Në rastin e të paraburgosurit A.H gjykata nuk ka patur për objekt shqyrtimi dhënien e ndonjë leje të veçantë për betimin e tij por ka shqyrtuar kërkesën e tij për zëvendësimin/revokimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me arsyetimin se në rastin e A.H nuk ekziston më rreziku i ikjes dhe se nuk ka të dhëna se mund të kryejë tjetër vepër penale si dhe për arsyen tjetër se mandatimi i tij si deputet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 73/2 të Kushtetutës në fuqi në vitin 2001 çdo veprimi mëtejshëm procedural ndaj deputetit të akuzuar mund të ndërmerrej vetëm pasi nga organi i akuzës të jetë kërkuar dhe marrë

<sup>14</sup> Vendimi dt. 23.07.2021 dhe vendimi nr. 17/5 dt. 09.11.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

autorizimi për ndjekjen penale nga Kuvendi. Ndërkohë që në rastin e ankuesit gjykatat e të treja shkallëve të gjyqësorit me vendimet përkatëse kanë arsyetuar se fakti që i pandehuri ka fituar mandatin e kryetarit të Bashkisë Himarë apo kërkesa e tij për tu betuar para Këshillit Bashkiak nuk është shkak ligjor që të çojë në zëvendësimin e masës së sigurimit arrest në burg me një tjetër masë sigurimi më të butë. Ndërsa në lidhje me shtetasin M.F rezulton se me vendimin nr. 17/5 datë 09.11.2015 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit M.F për lejën e veçantë për të marrë pjesë si deputet i Kuvendit në komisionet përkatëse dhe në seancat plenare. Në këtë vendim gjyqësor gjykata ndër të tjera ka arsyetuar : “... Kolegji penal vlerëson se në rrethanat konkrete, masa e sigurimit personal e caktuar ndaj personit nën hetim M.F sipas ligjit e kufizon personin në një numër të caktuar të drejtash dhe lirish, përfshirë edhe të drejtën e tij për të ushtruar funksionin e deputetit me qëllim për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, kur janë të pranishme nevojat procedurale që kanë legjitimuar aplikimin e masës së sigurimit personal arrest në burg”. Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, gjykata arrin në konkluzionin se rastet e praktikës gjyqësore të identifikuar nga ankuesi si raste në të cilat ligji që parashikon të drejtat e të paraburgosurve apo të dënuarve me burgim është interpretuar në favor të dhënies së lejës së veçantë për të kryer betimin nuk janë të njëjta me rrethanat faktike dhe procedurale që i përkasin rastit të ankuesit Dhionisios Alfred Beleri.

Gjithashtu gjatë gjykimit ankuesi Dhionisios Alfred Beleri parashitroi se me anën e mosdhënies së lejës së veçantë për të kryer betimin nga ana e Gjykatës do të mundësohej që drejtimi i Bashkisë Himarë të vijojë që të bëhet nga kandidati humbës në zgjedhjet vendore të zhvilluara në datën 14 maji 2023. Në lidhje me këtë pretendim gjykata vlerëson se nuk është detyrë e kësaj gjykate gjetja e mënyrave për sigurimin e funksionalitetit të qeverisjes në Bashkinë Himarë, por vlen të theksohet se nga një analizë e modeleve të legjislacioneve evropiane, si psh Spanjë, Itali, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, përfshirë edhe Shqipërinë, në situatat ku qeveria lokale për shkaqe të caktuara konsiderohet e paaftë të përmbushë detyrat e saj efektivisht, administrimi i përkohshëm i qeverisjes lokale mund të kryhet nga ana e qeverisë qendrore. Arsyet dhe metodat për këtë ndërhyrje mund të ndryshojnë nga shteti në shtet, por përvec keqmenaxhimit financiar, gjëndjes së fatkeqësisë natyrore apo emergjencës, pamundësia e funksionimit të qeverisjes vendore për shkaqe ligjore ose kushtetuese, është shkak për mundësinë e qeverisjes qendrore të ndërhyjë, për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve publike. I takon qeverisjes qendrore, që bazuar në parimin e përgjegjësisë për të siguruar qeverisjen efektive, ligjore dhe të drejtën e qytetarëve për shërbime publike të qëndrueshme, të marrë masa, konform kuadrit ligjor dhe modeleve më të mira evropiane, për gjetjen e zgjidhjes.

Në përfundim, në analizë me sa u argumentua më sipër, Gjykata, vlerëson se situata e krijuar në kontekstin e zbatimit të parashikimeve ligjore lidhur me kufizimin e lirisë personale të personave të ndodhur në kushtet e paraburgimit lexuar së bashku me të drejtat e të paraburgosurve për leje të veçantë, çon në pamundësinë e kërkuesit për tu betuar e marrë detyrën publike, si dhe rrjedhimisht në pamundësinë e funksionimit të qeverisjes në Bashkinë Himarë. Këto pamundësi nuk përbëjnë shkak për këtë gjykatë që të tejkalojë kompetencat ligjore apo interpretojë ligjin në mënyrë që të vërë në rrezik dhënien e drejtësisë në procesin penal.



**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata bazuar në nenin 112 të K.Pr.Penale dhe nenet 8, 73 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

**VENDOSI:**

1. Rrëzimin e ankimit të ankuesit Dhionisios Alfred Beleri me Nr. 467 Regj. Them. Dt. Regj. 16.11.2023 me objekt “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. dt. 08.09.2023, njoftuar në datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë” si një kërkesë e pa bazuar në ligj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë sot më datën 11.12.2023


**GJYQTARE**

**IRENA GJOKA**



**GJYQTARE**

**FLORA HAJREDINAJ**



**GJYQTAR**

**ERJON ÇELA**



**SEKRETARE**

**ERBLINA DARDHA**

